



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 26.01.2022, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a. për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE, për licencimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a., në aktivitetin e operimit të hapësirave të depozitimit të gazit natyror.
2. Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 187, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes të gazit natyror”, i ndryshuar dhe një ndryshim në vendimin e bordit të ERE nr. 188, datë 10.11.2017, “Për licencimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror”, i ndryshuar.
3. Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s, nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi çertifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror”, Albgaz sh.a.”, i ndryshuar.
4. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin Dhjetor 2021.